



KRUJË
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA TEKNOLOGJIA UAV


Nis fotografimi i ri ajror i territorit të Republikës së Shqipërisë

Më datë 25 gusht 2026 nisi zyrtarisht procesi i fotografimit të ri ajror të territorit të Republikës së Shqipërisë, një projekt i rëndësishëm që realizohet në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet ASIG dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH), me synim përditësimin e informacionit gjeohapësinor dhe forcimin e kapaciteteve për monitorimin, planifikimin dhe administrimin e territorit. Faza e parë e projektit përfshin fotografimin ajror të një sipërfaqeje prej 680 km² në zonat urbane, me rezolucion tokësor (GSD) prej 5 cm, si dhe skanimin LiDAR me densitet prej 10 pikash/m², për përfitim të dhënave gjeohapësinore me cilësi dhe saktësi të lartë. Qëllimi kryesor i projektit është përditësimi dhe zhvillimi i Hartës Bazë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke mundur krijimin e informacionit hartografik të saktë, të detajuar dhe të përditësuar.

Për herë të parë, projekti përfshin edhe fotografimin ajror oblik, i cili mundëson krijimin e produkteve të avancuara gjeohapësinore, përfshirë modele urbane tredimensionale (3D City Models). Këto të dhëna krijojnë mundësi të reja për analizën, vizualizimin dhe administrimin e zonave urbane, si dhe për monitorimin e mjedisit dhe të bujqësisë.



Gjurma e fluturimit – Zona urbane e Fierit




Gjurma e fluturimit – Zona urbane e Vlorës


Publikohet Informacion Gjeohapësinor për temën “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar informacionin gjeohapësinor për shtresën “Landfille”, pjesë e temës “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”. Kjo shtresë përmban informacion mbi vendndodhjen e landfilleve dhe specifikat teknike të përcaktuara në lejet përkatëse.

Të dhënat janë gjeneruar në bazë të listës së përcaktuar nga Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM) dhe janë përfutur në mënyrë digjitale nga AKM, përmes procesit të digjitalizimit, sistematizimit dhe përpunimit të informacionit të nxjerrë nga lejet e mjedisit. Këto të dhëna janë konform Standardeve Shtetërore për Specifikimet Teknike të Informacionit Gjeohapësinor në Shqipëri, për temën “Infrastruktura urbane dhe shërbimet qeveritare”, të miratuara me VKM-në nr. 998, datë 9.12.2020.



Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e dëmeve nga zjarri



Në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ASIG ka analizuar dëmet e shkaktuara nga zjarret në disa zona të vendit: Krujë; Halil (Krujë); Mali i Dardhës (Librazhd); Ribë (Mallakastër); Lurë dhe Selishtë (Dibër); si dhe Kavajë. Analiza krahasuese e imazheve satelitore dhe e të dhënave për mbulesën e tokës, për periudhat para dhe pas zjarreve, ka mundësuar identifikimin e sipërfaqeve të dëmtuara dhe të kategorive kryesore të mbulesës së tokës që janë prekur. Për çdo zonë janë përgatitur harta tematike, statistika të sipërfaqeve të prekura dhe analiza krahasuese të gjendjes para dhe pas zjarreve, duke krijuar një pasqyrë të qartë të ndikimit të zjarreve në territor. Këto produkte synojnë të mbështesin monitorimin e territorit, vlerësimin e dëmeve dhe vendimmarrjen institucionale, duke shfrytëzuar potencialin e teknologjive Remote Sensing dhe GIS në menaxhimin e situatave emergjente.

Fotografimi i gjeoreferencuar 360° i rrjetit rrugor kombëtar

Fotografitë panoramike 360° të gjeoreferencuara, të realizuara nga ASIG dhe të publikuara në Gjeoportalin Kombëtar, mbulojnë:

- zonën e Dibrës, përfshirë Maqellarën, Peshkopinë dhe akset Peshkopi–Lurë–Rrëshen (SH34) e Peshkopi–Fushë–Studë – 195 km;
- rrugët urbane dhe kombëtare në Finiq e Konispol, si dhe aksin Delvinë–Jorgucat – 76 km.

Në mbështetje të Bashkisë Mat, ASIG ka fotografuar edhe 58 km akse rrugore për dokumentimin dhe promovimin e pikave turistike dhe objekteve të trashëgimisë historike e kulturore.



Pamje panoramike 360°

Aksi Peshkopi–Lurë–Rrëshen


Rilevimi me teknologjinë UAV - Qyteti i Krujës

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, ASIG vijon realizimin dhe përpunimin e ortofotove të përditësuara me teknologjinë UAV, në mbështetje të procesit të Regjistrimit Fillestar të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). Këtë muaj, ASIG ka realizuar rilevimin dhe ka përgatitur ortofoton e qytetit të Krujës, që mbulon 4 km².


Përdorimi i ortofotove të përditësuara do të kontribuojë në:

- identifikimin më të saktë të objekteve dhe parcelave;
- përmirësimin e cilësisë së verifikimeve në terren;
- rritjen e saktësisë së produkteve përfundimtare kadastrale.

Kjo nismë mbështet administrimin e territorit përmes teknologjive moderne dhe të dhënave cilësore gjeohapësinore.



Modeli Digjital i Sipërfaqes (DSM) – Krujë



Harta e izoipseve – Krujë

BOTA E GJEONFORMACIONIT

Sentinel-3 përshpejton transmetimin e të dhënave për zjarret në Evropë

Një strategji e re e zhvilluar nga Agjencia Evropiane e Hapësirës (ESA – European Space Agency) dhe Organizata Evropiane për Shfrytëzimin e Satelitëve Meteorologjikë (EUMETSAT – European Organisation for the Exploitation of Meteorological Satellites) ka përshpejtuar transmetimin e të dhënave të Sentinel-3 të shërbimet e emergjencës. Imazhet e Evropës Qendrore dhe Jugore tashmë mund të jenë të disponueshme brenda 60–90 minutash, në vend të rreth tri orëve. Kjo mundëson reagim më të shpejtë ndaj zjarreve dhe ndihmon në kufizimin e dëmeve.

Copernicus publikon të dhënat e vitit 2024 për mbulesën bimore të tokës

Shërbimi Copernicus për Monitorimin e Tokës (CLMS – Copernicus Land Monitoring Service) ka publikuar shtresat e vitit referencë 2024 të produktit “Karakteristikat e mbulesës bimore të tokës me rezolucion të lartë” (HR-VLCC – High Resolution Vegetated Land Cover Characteristics). Të dhënat për tokat bujqësore, kullotat, mbulesën me pemë dhe pyjet janë të aksesueshme përmes Ekosistemit të Hapësirës së të Dhënave Copernicus (CDSE – Copernicus Data Space Ecosystem), së bashku me serinë historike 2017–2023. Të dhënat e hapura dhe të harmonizuara mbulojnë 38 vendet anëtare dhe bashkëpunëtorë të Agjencisë Evropiane të Mjedisit (përfshirë Shqipërinë), si dhe Mbretërinë e Bashkuar, dhe mbështesin monitorimin mjedisor e bujqësor, vlerësimin e biodiversitetit dhe studimet mbi ndryshimet klimatike.

AKTIVITETE NË VIJIM

INTERGEO 2026

Nga 15–17 shtator 2026, në Mynih të Gjermanisë, do të zhvillohet INTERGEO Munich 2026, panairi dhe konferenca më e rëndësishme evropiane në fushën e gjeoinformacionit. Aktiviteti do të mbledhë kompani, institucione kërkimore, organizata publike dhe profesionistë të sektorit gjeohapësinor për të prezantuar risitë më të fundit në GIS, dronë, qytete inteligjente, matje topografike dhe transformim digjital.

15–17 shtator 2026

Esri Spain 2026

Më 30 shtator – 1 tetor 2026, në Madrid të Spanjës, do të zhvillohet konferenca Esri Spain 2026, një nga aktivitetet kryesore të komunitetit GIS në Spanjë. Aktiviteti do të prezantojë zhvillimet më të fundit në teknologjitë gjeohapësinore, përmes sesioneve teknike, rasteve të përdorimit dhe diskutimeve mbi tendencat dhe sfidat e reja në fushën e GIS-it, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet profesionistëve të fushës.

30 shtator – 1 tetor 2026

QGIS User Conference 2026

Më 5–6 tetor 2026, në Laax, të Zvicrës, do të zhvillohet QGIS User Conference, konferenca e përdoruesve dhe zhvilluesve të softuerit QGIS me burim të hapur. Aktiviteti ofron një platformë për prezantimin e zhvillimeve më të fundit të QGIS, shkëmbimin e përvojave praktike dhe forcimin e rrjetit profesional ndërmjet pjesëmarrësve nga industria, akademja dhe komuniteti global i teknologjive gjeohapësinore.

5–6 tetor 2026